

UDHËZUES

PËR NJË PRODHIM TË PASTËR DHE TË QËNDRUESHËM TË MANDARINAVE

Kultivimi i mandarinave shqiptare dhe përvoja “MandaGREEN”



Ky udhëzues është krijuar nga projekti MandaGREEN, mbështetur nga GreenAL i cili zbatohet nga Co-PLAN, COSV dhe VIS Albania. Pikëpamjet dhe përfundimet e përfshira këtu nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht ato të Qeverisë Suedeze ose të Agjencisë Ndërkombëtare Suedeze për Bashkëpunim për Zhvillim (Sida).

Përmbajtja

1. Hyrja dhe qëllimi i udhëzuesit.....	3
2. Konteksti i bujqësisë shqiptare dhe sfidat aktuale	4
3. Pesticidet dhe pasojat e tyre të padukshme.....	5
4. Nga kimikatat e toka e gjallë.....	6
5. Alternativat natyrore për mbrojtjen e bimëve.....	7
6. Praktikat ekologjike që funksionojnë	8
7. Standardet ndërkombëtare BIO dhe Global G.A.P.	10
8. Modeli i agrumeve shqiptare – pritshmëria nga MandaGREEN.....	10
9. Advokimi lokal dhe ndërgjegjësimi komunitar.....	11
10. Mesazhi etik dhe reflektimi për të ardhmen.....	12
11. Shtojcë – Rekomandime konkrete	12
Për fermerët:	12
Për bashkitë:	12
Për institucionet qendrore:	12
12. Referenca të zgjeruara	12

1. Hyrja dhe qëllimi i udhëzuesit

► Bujqësia shqiptare është në një pikë të rëndësishme tranzicioni: nga modeli tradicional i përdorimit të pakontrolluar të pesticideve drejt një modeli më të pastër, ekologjik dhe ekonomikisht më të qëndrueshëm. Ndërkaq, roli i fermerit po ridimensionohet përtej të qenit vetëm një prodhues, duke u shtrirë në funksionin e ruajtësit të jetës, tokës dhe ushqimit. Çdo veprim që ai ndërmerr – spërkatje, plehërim, vaditje apo zgjedhje kulture – ndikon drejtpërdrejt në shëndetin e familjes, të komunitetit dhe të brezave që do të vijnë.

► Në këtë kontekst vjen ky udhëzues i krijuar si rezultat i përvojave të nismës MandaGREEN në kuadër të projektit GreenAL, për t’u ardhur në ndihmë së pari fermerëve shqiptarë, pa përjashtuar institucionet vendore, shkollat bujqësore dhe çdo kënd që beson se toka dhe kulturat bujqësore janë një pasuri që duhet mbrojtur.

► Qëllimi i tij kryesor është të përhapë njohuri e ide të dobishme, të thjeshta, të mbështetura sa në teori ashtu edhe në përvoja praktike e traditë, për të ndihmuar kalimin e bujqësisë sonë nga modeli kimik në një model ekologjik, të qëndrueshëm dhe të drejtë për natyrën dhe njeriun. Udhëzuesi mbështet veçanërisht fermerët prodhues të mandarinave në rrugën drejt bujqësisë së pastër dhe të zgjuar duke treguar se ndryshimi është i mundur, nëse fillon nga dora që mbjell.

► Në këtë kontekst, përvojat reale me kultivimin e mandarinës shqiptare në zonën Poshnjë–Dimal vërtetuan se ky ndryshim mund të ndodhë madje edhe në kushte modeste, nëse ekziston vullneti, bashkëpunimi dhe dëshira për të mësuar. Vetë fermerët vendas të përfshirë në aktivitetet e projektit do të arrijnë në përfundimin se përdorimi i metodave organike do të bënte që toka “të merrte frymë e të kishte përsëri jetë”.

► Ky udhëzues i ndërtuar në frymën e këtyre fjalëve përmbledh shembuj konkretë, praktika të thjeshta e të provuara, citime nga fermerë dhe referenca nga dokumentet kombëtare e ndërkombëtare. Ai nuk është një manual thjesht teorik, por një udhërrëfyes praktik për ata që duan të kultivojnë me ndërgjegje dhe dashuri.

2. Konteksti i bujqësisë shqiptare dhe sfidat aktuale në sektorin e kultivimit të agrumeve-mandarinave

► Aktualisht bujqësia shqiptare duke përfshirë edhe sektorin e kultivimit të agrumeve, ndodhet në një situatë të ndërlikuar. Edhe pse ekzistojnë të gjitha kushtet e favorshme klimatike për kultivimin e suksesshëm të tyre, veçanërisht të mandarinës, shumica e fermave funksionojnë ende me metoda konvencionale, të mbështetura fort te pesticidet sintetike dhe plehrat kimikë. Ndërkaq, sipas “Raportit Kombëtar mbi Përdorimin e Pesticideve në Shqipëri”¹ rreth 62% e fermerëve nuk kanë akses të rregullt në këshillim teknik për përdorimin e pesticideve dhe zakonisht i blejnë pesticidet nga tregtarë ambulantë, shpesh pa etiketë shqip. Shkaku kryesor është pamjaftueshmëria e shërbimeve të ekstensionit bujqësor dhe mbikëqyrjes fitosanitare në nivel lokal.

► Gjithashtu, sipas “Raportit rreth përdorimit të pesticideve në mandarina 2025”² në zonat e kultivimit të mandarinave në qarkun Berat, mbi 60% e fermerëve deklarojnë se nuk ndjekin këshillim teknik kur përdorin pesticide. Shumë prej tyre i blejnë produktet nga tregtarë ambulantë, pa etiketë në gjuhën shqipe, pa datë prodhimi dhe pa paralajmërime të qarta mbi rreziqet.

► Agrumishtet biologjike, në të kundërt, funksionojnë mbi parimin: “Pa pesticide sintetike, pa plehra kimikë, pa mbetje toksike në produkt.” Kjo qasje është e mbështetur nga standardet BIO të BE-së dhe kërkon përdorim të inputeve organike, plehërim natyror dhe kontroll biologjik të dëmtuesve. Në qarkun e Beratit, sidomos në njësinë administrative Poshnjë- DIMAL, fermerët kanë potencial të madh për t’u certifikuar sipas standardeve **BIO (bujqësi pa pesticide sintetike)** falë:


- klimës së favorshme subtropikale,
- tokave të mira argjilo-ranore
- përvojës tradicionale në agrume
- pranisë së rrjeteve të vogla ujitjeje me pika

► Ndërkaq, fermerët e vegjël të sektorit që përbëjnë shumicën e prodhuesve vendorë mbajnë mbi supe sfida të mëdha – sipërfaqe toke të kufizuar, mjete të pakta, mungesë informacioni dhe shpesh mungesë kontrolli mbi produktet që përdorin.

¹ Raporti Kombëtar mbi Përdorimin e Pesticideve në Shqipëri” (FAO TCP/ALB/3701, 2022)

² Mbi praktikatat ekzistuese, njohuritë dhe qëndrimet e fermerëve të Bashkisë Dimal, qarku Berat në lidhje me përdorimin e pesticideve në mandarina 2025, (Projekti MandaGREEN)
http://www.natyraberat.org/wp-content/uploads/2025/11/Raport_mbi_perdorimin_e_pesticideve-PMSM-Berat-2.pdf

► Nga ana tjetër, fermerët e mëdhenj kanë më shumë mundësi për të përdorur pajisje moderne për të ndjekur trajnime, dhe për t'u certifikuar, por shpesh janë të fokusuar tek sasia, dhe jo tek cilësia. Kjo ndarje e madhe mes fermerëve të vegjël dhe të mëdhenj krijon një boshllëk në treg: produktet e pastra janë të pakta, ndërsa ato të trajtuara tepër dominojnë raftet.



► Ndërkohë, tregjet e huaja po kërkojnë gjithnjë e më shumë produkte BIO dhe me gjurmueshmëri. Kjo është një mundësi e artë për fermerët shqiptarë në përgjithësi dhe ata të qarkut Berat në veçanti, nëse arrijnë të përshtaten me standardet ndërkombëtare të cilësisë dhe sigurisë ushqimore.

► Për ta bërë këtë, është e nevojshme që të ketë vullnet nga ana e fermerëve, politika mbështetëse nga ana e institucioneve qendrore e vendore, edukim, certifikim të besueshëm dhe bashkëpunim midis institucioneve dhe fermerëve.

3. Pesticidet dhe pasojat e tyre të padukshme

► Pesticidet janë shpikje e njeriut për të mbrojtur bimën, por përdorimi i pakontrolluar i tyre është kthyer në kërcënim për shëndetin dhe natyrën. Shumë fermerë i përdorin pa doreza, pa maskë, pa orar të përshtatshëm dhe në ditë me erë.



► Në këto kushte, tymi i pesticideve përhapet, depërton në mushkëri, në tokë, në ujë dhe në produkt.

► Shumë fermerë ankohen për lodhje, marramendje dhe alergji — shenja të ekspozimit kronik. Një prej tyre tha në pushim të një trajnimi: “Helmi që përdor për insektet, po ma merr shëndetin ngadalë- ngadalë.”

► Pasojat janë të shumëfishta:

- **Në shëndetin e fermerit:** helmime akute, probleme nervore dhe sëmundje të mushkërive.
- **Te fruti,** mbetje toksike nëse nuk respektohet karenca
- **Në tokë:** humbje e mikroorganizmave, ngurtësim i strukturës, reduktim i pjellorisë.
- **Në ujë:** ndotje e kanaleve, lumenjve dhe ujërave nëntokësore.
- **Në biodiversitet:** zhdukja e bletëve, krimbave të tokës dhe zogjve që ushqehen me insekte.

► Në disa zona, bletët janë zhdukur plotësisht, dhe kjo ka ndikuar në uljen e rendimentit të kulturave. MandaGREEN e ka përfshirë këtë problem si prioritet në fushatat e saj për ndërgjegjësimin komunitar.

► Në sistemin BIO pesticidet sintetike janë të ndaluara. Lejohen vetëm preparatet me bazë bakri (në sasi të kufizuara), preparatet me vajra natyralë, inputet e lejuara në rregulloren organike të BE-së. Çdo përdorim i pesticideve kimike (Konfidor, Klerat, Poliram, etj.) është i papranueshëm në fermë BIO – ato përdoren vetëm në sistemin konvencional dhe vetëm sipas rregullave strikte të trajtimit.

► Rregullat për përdorimin e pesticideve

Rregullat për përdorimin e pesticideve zbatohen si përshkruhen në pikën gjashtë (Praktikat ekologjike që funksionojnë)

4. Nga kimikatet te toka e gjallë

► Toka është një organizëm i gjallë. Ajo ka nevojë për frymëmarrje, lagështi, mikroorganizma dhe ekuilibër. Plehrat kimikë japin rezultat të shpejtë, por në afat të gjatë e vdesin tokën.

► Kur toka ngurtësohet, ajo nuk përthith më ujë, nuk ruan lëndë ushqyese dhe humbet jetën e saj natyrore.

► Plehrat organikë – si komposti, plehu i dekompozuar mirë, plehu organik i pjekur, plehu i gjelbër mbetjet bimore të fermentuara dhe hithrat, algat e humusi i krimbave rikthejnë energjinë në tokë, përmirësojnë strukturën, rritin kapacitetin mbajtës të ujit dhe ushqejnë bimën ngadalë dhe natyrshëm.

Plehrat kimikë (NPK, ure, nitrat amoni, etj.) janë të ndaluar në fermë BIO.



► Në trajnimin “Teknika e plehërimit të agrumeve”, u theksua se:

- plehu organik duhet të aplikohet në fund të dimrit ose fillim të pranverës
- moshë e plehut është po aq e rëndësishme sa sasia
- duhet të jetë i dekompozuar mirë
- përzierja e mbetjeve bimë me hi druri jep rezultate të shkëlqyera në agrume
- një kilogram kompost i mirë përmirëson strukturën e tokës më shumë sesa disa kilogramë pleh kimik

► Fermerët që e kanë zbatuar këtë praktikë për dy vjet rresht, kanë raportuar rritje të pjellorisë dhe ulje të kostove. Toka “ringjallet” dhe bëhet më elastike, më e lagësht dhe më e pasur me jetë.

Përbërësi natyror	Qëllimi	Përdorimi praktik
Hudhra + speci djegës	Kundër afideve e kërpudhave	Ziej 200g hudhra + 2 specë në 2L ujë, hollo me 10L ujë
Hudhra	Kundër kërpudhave	200g hudhër në 10 litra ujë

5. Alternativat natyrore për mbrojtjen e bimëve

► Natyra ka recetat e saj. Ato janë të thjeshta, të lira dhe të sigurt për njeriun dhe bimën. Këto metoda nuk lënë mbetje, nuk dëmtojnë konsumatorin dhe rrisin qëndrueshmërinë afatgjatë të parcelës.

► Disa nga më të përdorurat janë:

- **Hudhra:** përgatitet një përzierje me 200g hudhër në 10 litra ujë; lëngu filtrohet dhe përdoret për spërkatje kundër kërpudhave.
- **Vaji i neem-it (Azadirachta indica) :** ndihmon kundër insekteve dhe kërpudhave. 5 ml për litër ujë, spërkatje çdo 10 ditë.
- **Soda e bukës:** 2 lugë gjelle në 1 litër ujë, ndihmon kundër mykut të bardhë, veçanërisht në agrume.
- **Uthulla e mollës:** pastron gjethet, dezinfektant i lehtë dhe rrit imunitetin e bimës.

Përbërësi natyror	Qëllimi	Përdorimi praktik
Vaj niemi	Kundër larvave	5 ml për 1L ujë, çdo 7 ditë
Uthull molle	Dezinfektim natyral	1 gotë në 10L ujë
Sapun i bardhë	Kundër mizave të bardha	30g në 1L ujë
Sodë buke	Kundër mykut	2 lugë gjelle në 1L ujë

► Këto metoda kërkojnë durim, por forcojnë ekuilibrin natyror të parcelës dhe krijojnë besim te konsumatori. Një bimë e trajtuar natyrshëm nuk jep fryt të madh në fillim, por pas dy vitesh fillon të shpërblejë me shije dhe jetëgjatësi. Fermerët që i kanë zbatuar këto metoda, raportojnë përmirësim të ndjeshëm të cilësisë së frutit dhe ulje të sëmundjeve.

► Njëri prej tyre tha:

“Për herë të parë, nuk më është dashur të blej asnjë pesticid kimik dhe prodhimi nuk ra.”

6. Praktikrat ekologjike që funksionojnë

1. Ndërsa **rotacioni i kulturave** është mënyra më e thjeshtë për ta mbajtur tokën të gjallë, tek mandarinat si pemë shumëvjeçare kjo nuk funksionon.

2. **Ndërrimi i pemëve jo prodhuese** e të vjetra me fidane të reja mandarinash parandalon shfaqjen e dëmtuesve dhe ruan balancën e lëndëve ushqyese.

3. **Mbjelljet shoqëruese** janë një sekret i vjetër i bujqësisë tradicionale: majdanozi, borziloku dhe nenexhiku largojnë insektet e dëmshme dhe përmirësojnë aromën e frutit.

4. **Kompostimi** është mënyra më ekonomike dhe ekologjike për të rikthyer mbetjet në vlerë. Bashkitë duhet të krijojnë **qendra të vogla kompostimi** në çdo njësi administrative për betjet organike të tregjeve dhe familjeve.

5. **Ujitja me pika** është e detyrueshme sipas standardeve BIO sepse shmang sëmundjet, kursen ujë dhe ruan tokën.

6. **Punimi minimal i tokës** është i nevojshëm për të ruajtur mikroorganizmat po ashtu edhe mbrojtja biologjike dhe parambrojtëse.

7. **Përdorimi i preparateve me bakër** (sipërfaqësor, lejohet në BIO) dhe spërkatja me vajra natyralë për mbrojtje biologjike dhe parambrojtje para ndodhjes së dëmtimit.

8. **Punimi minimal i tokës** për të ruajtur mikroorganizmat.



Një bujqësi e qëndrueshme është ciklike:
mbjellje → korrje → riciklim →
plehërim → mbjellje sërish.

► Kur ky cikël funksionon, toka mbetet pjellore, prodhimi i shëndetshëm dhe fshati i gjallë.

Shërbimi	Përshkrimi Teknik
Krasitja	Kryhet në fund të dimrit për të formuar kurorën dhe larguar degët e sëmura.
Ujitja me pika	Metoda më efikase për agrumet BIO; redukton lagështinë e tepërt dhe sëmundjet.
Pleherimi organik	Aplikimi i kompostit dhe plehut të pjekur 1-2 herë në vit.
Spërkatjet parandaluese BIO	Hudhra, neem, sodë buke, uthull molle – pa kimikate sintetike.
Menaxhimi i barërave	Shkulje manuale ose mulching; pa herbicide.
Monitorimi i dëmtuesve	Kontroll javor; vendosje kurthe feromonale.

Rregullat për Përdorimin e Pesticideve (Sipas Trajnimit MandaGREEN)	
Rregulli	Përshkrimi
Pajisjet mbrojtëse	Maskë, doreza, syze dhe veshje mbrojtëse janë të detyrueshme.
Respektimi i dozës	Doza e shkruar në etiketë; teprimi rrit rrezikun, jo efektin.
Respektimi i karencës	Koha midis trajnimit dhe korrjes duhet respektuar plotësisht.
Mos përzierja e preparateve	Preparatet nuk përzierhen pa udhëzim teknik.
Ndalimi i pesticideve të paautorizuara	Nuk lejohen produkte pa etiketë ose pa skedë teknike.
Aplikimi në kohën e duhur	Vetëm në mëngjes ose pasdite; jo në ditë me erë/shira.

7. Standardet ndërkombëtare BIO dhe Global G.A.P.

► Nëse duam që prodhimi shqiptar të konkurrojë në tregjet evropiane, duhet të zbatojmë **standardet e certifikimit**.

- **BIO** nënkupton bujqësi pa pesticide sintetike, pa OMGJ (organizma gjenetike të modifikuara), pa plehra kimike, periudhë tranzicioni 2-3 vjet, dokumentim të plotë të shërbimeve dhe vetëm inpute të lejuara.
- **Global G.A.P.** siguron se fermeri ndjek praktika të mira bujqësore : menaxhimi i ujit, plehërimi, higjiena, gjurmueshmëria, regjistrim të çdo aplikimi, përdorim të kontrolluar të pesticideve (për feramat JO BIO) dhe auditime të rregullta.

Procesi i certifikimit përfshin disa hapa:

1. Vetëvlerësimi i fermës.
2. Mbledhja e dokumenteve për inputet e përdorura.
3. Auditimi nga një trupë e akredituar.
4. Marrja e certifikatës dhe inspektimi periodik.

► Procesi i certifikimit sjell përfitime të menjëhershme: çmime më të mira, kërkesa më të larta dhe besim më i madh i konsumatorit.

8. Modeli i agrumeve shqiptare – pritshmëria nga MandaGREEN

► Ky projekt pilot pritet të sjellë si rezultate konkrete:

- parcela pilot e mandarinës propozojmë të kalojë gradualisht në status BIO
 - reduktim të pesticideve,
 - rritje të prodhimit
 - përdorim të ujitjes me pika dhe plehrave organikë.
 - vendosja e qendrave të kompostimit
 - të krijohet një zinxhir i pastër nga ferma në treg
 - Fermerët e bashkuar në grupin e advokimit ndajnë eksperiencat e tyre.
 - Bashkia Dimal ngre pika për grumbullimin e ambalazheve bosh.
- Në fund të sezonit, mandarinat e parcelës pilot do të kenë cilësi të matshme.



► Një fermer nga Poshnja tha: “Kur di se çfarë ha familja ime, kjo nuk ka të paguar”. Ky është modeli i MandaGREEN që synon të zgjerohet e përhapet edhe në zona të tjera të qarkut Berat si dhe zona të tjera subtropikale shqiptare ku kultivohet mandarina.

9. Advokimi lokal dhe ndërgjegjësimi komunitar

► Ndryshimi nuk ndodh vetëm në arë. Ai fillon në mendje dhe konkretizohet tek bashkimi. Fermerët që bashkohen në grupe advokuese kanë më shumë fuqi për të kërkuar ndihmë, për të rregulluar tregun dhe për të mbrojtur interesat e tyre.


► Nëse fermerët nuk organizohen, vendimet merren për ta, por pa ta.

Me një grup advokues ata mund të ndikojnë që:

- të orientojë fermerët drejt certifikimit BIO
- të kërkojnë më shumë subvencione specifike për inpute organike për agrumet,
- të kenë trajnime për përdorimin e pesticideve,
- të edukojë konsumatorin të kërkojë fruta pa mbetje kimike
- të promovojë tregjet lokale BIO
- të bashkëpunojë me bashkinë për shërbime mbështetëse
- të sigurojnë që produktet e tyre të jenë të pranueshme në tregjet ndërkombëtare

► Fermerët e mandarinave në Berat janë bashkuar në grupin advokues MandaGREEN dhe kanë hartuar një plan advokimi që zëri i tyre të dëgjohet.

► Ata do ta paraqesin atë pranë strukturave përkatëse administrative dhe vendimmarrëse të pushtetit vendor e qendror, mediave, komunitetit vendor dhe publikut të gjerë. Konsumatori është pjesë e këtij zinxhiri.



► Fushata e MandaGREEN do të vijojë me mesazhe të thjeshta:

“Pyet për pastërtinë e ushqimit tënd.” Sepse vetëm kur konsumatori pyet, tregu bëhet më i drejtë.

► Në disa bashki, mund të zhvillohen edhe orë mësimore me nxënës për të mësuar që ushqimi i pastër fillon në tokë. Kjo është mënyra më e mirë për të ndërtuar breza të vetëdijshëm.

10. Mesazhi etik dhe reflektimi për të ardhmen

1. Toka nuk është pronë për t'u shfrytëzuar, por thesar për t'u ruajtur.
 2. Fermeri i sotëm duhet të kuptojë se çdo grusht dhe është një qenie e gjallë që pret respekt.
 3. Nëse e mbjell me helme, do të korrësh varfëri; nëse e mbjell me dashuri, do të korrësh shëndet.
 4. Etika e bujqësisë së pastër: respekt për tokën, për jetën dhe për njeriun.
- Bujqësia biologjike nuk është modë – është domosdoshmëri.

11. Shtojcë – Rekomandime konkrete

Për fermerët:

Lexoni çdo etiketë para përdorimit.
Mos spërkatni në erë apo diell të fortë.
Përdorni maskë dhe doreza gjatë punës.
Mos hidhni ambalazhet bosh në arë apo lumë.
Bashkohuni në grupe për trajnime dhe certifikim BIO.
Investoni në plehra organikë dhe ujitje me pika.

Për bashkitë:

Krijoni pika për grumbullimin e ambalazheve bosh.
Promovoni tregjet lokale për produkte të pastra.
Nxisni programet e kompostimit komunitar.
Edukoni komunitetin për bujqësi të pastër.

Për institucionet qendrore:

Rritni kontrollet për shitjen e pesticideve dhe produktet e trajtuara me to.
Subvenciononi plehrat organikë.
Mbështetni certifikimin BIO dhe Global G.A.P.
Zbatoni strategjitë kombëtare me projekte pilot në çdo qark.

Referenca të zgjeruara

- Strategjia Kombëtare e Sigurisë Ushqimore 2021–2027.
- Strategjia Kombëtare e Energjisë 2023–2030.
- Politika e Gjellbër e Bashkimit Europian (EU Green Deal).
- Strategjia Kombëtare për Punësim dhe Aftësim Profesional 2023–2030.
- Strategjia Kombëtare e Zhvillimit Rural dhe Bujqësisë 2021–2027.
- Programi IPARD III (2021–2027) – Instrumenti i Para-Aderimit të BE për Zhvillim Rural.
- Foto dhe ilustrime nga trajnimet MandaGREEN (2024–2025).
- Raporti mbi përdorimin e pesticideve në Shqipëri, 2025.
- Raporti i trajnimeve MandaGREEN (2025).
- Manuali i advokacisë dhe dokumentimi i praktikave ekologjike.
- Prezantimet: “Agrumet Poshnje 2025”, “Rregullat e përdorimit të pesticideve”, “Standardet BIO dhe Global G.A.P.”, “Teknika e plehërimit të agrumeve”, “Teknologjia e kultivimit të agrumeve”, “Advokimi dhe teknikat e tij”



Ky udhëzues është krijuar nga projekti MandaGREEN, mbështetur nga GreenAL i cili zbatohet nga Co-PLAN, COSV dhe VIS Albania. Pikëpamjet dhe përfundimet e përfshira këtu nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht ato të Qeverisë Suedeze ose të Agjencisë Ndërkombëtare Suedeze për Bashkëpunim për Zhvillim (Sida).